



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:112546
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05847760

KPPP.nr. 145/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovë” me seli në Prishtinë, kundër debitorëve “Unio-Commerce” Sh.p.k me numër të bizensit 70382499, me seli në Hanë të Elezit, 2. SH.B., 3. S.B., 4. I.B., 5, Z.B., 6. S.B., të gjithë nga fshati ..., Komuna Hani i Elezit, 7. “Newco Silcapor” L.L.C me seli në fashtin Doganaj , Komuna Kaqanik, të cilit i përfaqëson avokati Daut Rudi, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr. 162/14, të lejuar me datë 18.07.2014, nga Përmbaruesi Privat Fadil I. Hoxha, pas mbajtjes së seancës publike dëgjimore për shqyrtimin e validitetit të prapësimit të debitorit të datës 12.06.2024, ndërsa me datën 21.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura e përmbarimit sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr. 162/14, të lejuar me datë 18.07.2014, nga Përmbaruesi Privat Fadil I. Hoxha, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovë”, ndaj debitorëve “Unio-Commerce” Sh.p.k, 2. SH.B., 3. S.B., 4. I.B., 5, Z.B., 6. S.B., 7. “Newco Silcapor” L.L.C.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovë” Sh.A., mbi bazën e dokumenteve përmbarimore marrëveshje e kredive dhe shtojcat, listat e pengut dhe listat e pengut nga zyra e regjistrimit të pengut, Marrëveshjet për hipotekat dhe Aktvendimet për regjistrimin e hipotekave, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.162/2014, të datës 18.07.2014, me të cilin është janë detyruar debitorët t’ia paguajnë borxhin e mbetur në shumë prej 2,042.311.25 €, duke e llogaritur kamatën e rregullt dhe kamatëvonesën që do të arrijë deri në pagesën definitive, ka urdhëruar të gjitha Institucionet Financiar se në rast se kanë mjete atëherë

të transferohen përmes llogarisë së veçantë të organit përmbarues me qëllim të përmbylljes së obligimit. Në rast të mos realizimit me anë të llogarive bankare, të sekuestrohet kolaterali i debitorëve sipas kontratës së pengut dhe të njëjtat ti dorëzohen kreditorit për ti shitur, që nga çmimi i shitblerjes të përmbushet obligimi i debitorit, si dhe të detyrohen debitorët që të kompensojnë shpenzimet procedurale aq sa ato do jenë të llogaritura nga zyra përmbarimore sipas udhëzimit Administrativ nr.06/2014 Udhëzim për tarifatat për shpërblimet dhe kompensimin për përmbaruesit privat.

Ndaj këtij urdhri përmbarimor, debitorët kanë paraqitur prapësim me të cilin e kanë kundërshtuar në tërësi si të pabazuar urdhrin mbi lejin e përmbarimit, ndër të tjerash kanë kërkuar që urdhri për përmbarim i përmbaruesit privat Fadil Hoxha P.nr.162/14 të datës 18.07.2014, të hudhet si i pa lejuar ose që i njëjti të revokohet, kanë theksuar se për të njëjtën çështje dhe lidhur me kreditim të njëjtë pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj zhvillohet një procedurë përmbarimore e cila është e regjistruar me E.nr.44/13.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se prapësimi i ushtruar nga ana e debitorëve është plotësisht i pa themeltë dhe i pa bazuar pasi që debitorët asnjë nga shkaqet e prapësimit nuk e kanë mbështetur me asnjë provë. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorëve të refuzohet në tërësi si i pabazuar dhe urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, me qëllim të shqyrtimit të validitetit të prapësimit të debitorëve, me datë 12.06.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse.

Në seancën e mbajtur dëgjimore, kreditori ka theksuar se ka parashtruar pranë përmbaruesit privat tërheqjen e propozimit për përmbarim dhe sipas njohurive përmbaruesi privat e ka aprovuar të tërhequr dhe e ka përfunduar procedurën përmbarimore.

Përfaqësuesi i autorizuar i debitorëve, në seancën e mbajtur dëgjimore, ka theksuar se po ashtu kjo çështje ka përfunduar me vendim të Gjykatës së Apelit, Supremes dhe Kushtetutës, e të cilat gjinden në shkresat e lëndës është e gjykuar në procedurë përmbarimore me konkluzionin me numër P.nr.03/2016 të datës 05.04.2022.

Gjykata në ri procedurë duke i pasur parasysh sugjerimet dhe vërejtjet e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë sipas vendimit Ac.nr.4397/2015 të datës 28.09.2018, e pasi shqyrtimit të pretendimeve të palëve, shkresat e lëndës, si dhe vlerësimit të Konkluzionit të lëshuar nga Përmbaruesi Privat P.nr.03/2016, të datës 05.04.2022, gjeti është aprovuar kërkesa për tërheqje të propozimit në këtë çështje përmbarimore dhe janë shfuqizuar të gjitha veprimet përmbarimore. Prandaj, në kuptim të dispozitave nga neni 66.1 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke përfunduar procedurën përmbarimore sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr. 942/2020, të datës 26.10.2020, për shkak të tërheqjes së propozimit për përmbarim nga ana e kreditorit.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 66.4 të LPP-së, dhe nenit 13, pika 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 145/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.